



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ .2024

**VENDIM**

**Nr. 70, datë 15.02.2024**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE  
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU  
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE  
KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Eglantina Mikani (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Olkeda Lice si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Entela Shedula, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, etj; Akuza: Nenet 78/2, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Marçela Shehu dhe Gentian Marku, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Luljeta Kole (Trebicka), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: Nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2, 280 të Kodit Penal (Dosje e kthyer për rigjykim).

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Matilda Llangozi (relatore) dhe Albert Meça, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Ilir Përdeda, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, etj; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Paulin Çera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 130/a/1, 28/4, 333/a/2, 334 të Kodit Penal (Dosje penale në seancë paraprake).

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**